

Emri i Lëndës : Sjellje Organizative							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
EMS 211	B	Vjeshtë	3.00	1.00	0.00	3.50	5.00
Lektori		Eduina Maksuti, Msc					
Asistenti		Gesjana Kaba, Msc					
Gjuha e kursit		Anglisht					
Niveli i lëndës		Bachelor					
Përshkrimi		<p>Kjo lëndë i përkufizon organizatat si mjedise pune. Ajo është e fokusuar në lidhjen midis individit, grupit dhe gjithë organizatës. Në mënyrë të veçantë, lënda përshkruan vlerën e lidhjes midis punës dhe familjes, individëve dhe ekipeve, organizatave dhe shoqërisë në kërkim të prosperitetit të ardhshëm. Lënda luan një rol vendimtar në përcaktimin e aftësive të studentëve që i ndihmojnë ata të zgjedhin mënyrën duhur të veprimit, me synimin për të kontribuar më shumë në performancën e tyre individuale dhe organizative gjatë gjithë karrierës së tyre. Metodologjia e mësimdhënies dhe pedagogjia janë multidisiplinare dhe mbështeten në metoda dhe teknika të ndryshme. Qëllimi kryesor është njohja nga studentët e rëndësisë së sjelljeve njerëzore dhe angazhimi i tyre në organizata. Gjithashtu, synohet rritja e njohurive dhe aftësive të tyre, në mënyrë që të jenë të përgatitur për t'u bërë liderët e nesërm në organizata.</p>					
Objektivat		<p>Lënda synon t'u japë studentëve një vlerësim të natyrës unike të qenieve njerëzore si punonjës; Të sigurojë që studentët të njohin variablat kryesore të pavarura dhe të varura të sjelljes organizative; Të ndihmojë studentët të jenë anëtarë efektivë të ekipit dhe/ose udhëheqës të ekipit; Të ndajë me studentët njohuritë teorike dhe praktike që janë të nevojshme për të kuptuar personalitetet, perceptimet dhe motivimet e punonjësve; të ndërtojnë skuadra që gëzojnë unitet, kënaqësi dhe performancë të lartë; të kuptojnë organizatat komplekse-adaptuese nëpërmjet mekanizmave efektivë të komunikimit, menaxhimit të konflikteve dhe udhëheqjes përfshirëse.</p>					
Konceptet Kryesore		Sjellje organizative, personalitet, etikë, skuadër, vendimmarrje.					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Hyrje në fushën e sjelljes organizative. Ky kapitull paraqet katër këndvështrime të efektshmërisë organizative. Seksioni i efektshmërisë organizative gjithashtu siguron organizimin e sistemeve të hapura, të mësuarit organizativ, praktikat e punës me performancë të lartë, vlerat dhe etikën. (McShane, 2022, fq. 2-32)						
2	Sjellja, personaliteti dhe vlerat individuale. Ky kapitull prezanton modelin MARS të sjelljes dhe performancës individuale, personalitetin në organizata, vetë-konceptin, vlerat në vendin e punës dhe vlerat etike dhe sjelljen. (McShane, 2022, fq. 32-65)						
3	Të perceptojmë veten dhe të tjerët në organizata. Ky kapitull prezanton procesin perceptual, identitetin social dhe stereotipet, teorinë e Atributeve, profecitë vetë-përmbushëse, përmirësimin e perceptimeve dhe të mësuarit në organizata. (McShane, 2022, fq. 66-95)						
4	Ndjenjat, qëndrimet dhe stresi në vendin e punës. Ky kapitull prezanton emocionet në vendin e punës, menaxhimin e emocioneve në punë, inteligjencën emocionale, kënaqësinë në punë, angazhimin organizativ, stresin e lidhur me punën dhe menaxhimin e tij. (McShane, 2022, fq. 96-129)						
5	Motivimi i punonjësve. Ky kapitull prezanton angazhimin e punonjësve, shkaqet dhe nevojat e punonjësve, teorinë e motivimit, vendosjen e objektivave dhe drejtësinë organizative. (McShane, 2022, fq. 130-160)						

6	Vendimmarrja dhe krijimtaria. Ky kapitull prezanton paradigmën e zgjedhjes racionale të marrjes së vendimeve, identifikimin e problemeve dhe mundësive, vlerësimin dhe zgjedhjen e alternativave, zbatimin e vendimeve, vlerësimin e rezultateve të vendimeve dhe përfshirjen e punonjësve në marrjen e vendimeve. (McShane, 2022, fq.196-231)
7	Dinamika e ekipit. Ky kapitull prezanton avantazhet dhe disavantazhet e ekipeve, një model të efektivitetit të ekipit, elementet e strukturës të ekipit, proceset e ekipit dhe marrja së vendimeve të ekipit. (McShane, 2022, fq. 232-267)
8	Provimi Midterm
9	Komunikimi në ekipe dhe organizata. Ky kapitull prezanton rëndësinë e komunikimit, një model komunikimi, kanalet e komunikimit, zgjedhja e kanalit më të mirë të komunikimit, përmirësimi i komunikimit ndërpersonal etj. (McShane, 2022, fq. 268-297)
10	Fuqia dhe ndikimi në vendin e punës. Ky kapitull paraqet burimet e fuqisë në organizata, influencimi i të tjerëve, teknikat e influencimit dhe politikat organizacionale. (McShane, 2022, fq. 298-325)
11	Konflikti dhe negociimi në vendin e punës. Ky kapitull paraqet konceptet e konfrontimit konstruktiv, modeli i procesit të konfliktit, burimet strukturore të konfliktit në organizata, stilet ndërpersonale të trajtimit të konflikteve dhe qasjet strukturore të menaxhimit të konflikteve. (McShane, 2022, fq. 326-357)
12	Lidershipi në organizata. Ky kapitull prezanton se çfarë është lidershipi, perspektiva e lidershipit, perspektiva e sjelljes së lidershipit, perspektiva e parashikuesve së lidershipit, perspektiva shndërruese e lidershipit dhe perspektiva implicite e udhëheqjes. (McShane, 2022, fq. 358-383)
13	Projektimi i Strukturave Organizative. Ky kapitull paraqet elementet e strukturës organizative, format e departamentalizimit dhe parashikuesit e dizajnit organizativ. (McShane, 2022, fq. 384-413)
14	Kultura organizative. Ky kapitull prezanton elementet e kulturës organizative, deshifrimin e kulturës organizative nëpërmjet artefakteve. A është e rëndësishme kultura organizative? Shkrija e kulturave organizative dhe ndryshimi e forcimi i kulturës organizative. (McShane, 2022, fq. 414-440)
15	Përsëritje
16	Final Exam
Parakushtet	
	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.
Literatura	
	• McShane, S., Glinow, M. V (2022). Organizational Behavior. McGraw Hill Education.
Referenca të tjera	
	• Uhl-Bien, M., Piccolo, R. F., & Schermerhorn Jr, J. R. (2020). Organizational behavior. John Wiley & Sons.
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Njohja e botës perceptuese të punonjësve në organizata.
2	Të kuptuarit e emocioneve, personalitetit dhe vlerave të punonjësve.
3	Përcaktimi i kushteve për motivim dhe punës në grup.
4	Zgjidhja e konflikteve dhe influencimi nëpërmjet fuqisë dhe komunikimit.
5	Menaxhimi i diversitetit me anë të lidershipit përfshirës.
6	Ndryshimi i qëndrimeve për rritjen e kënaqësisë dhe performancës në punë.
7	Njohja e proceseve dhe karakteristikave të organizatës.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	40	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrare	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	10	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final		50	
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final		50	
Total		100	
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	4	56
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	2	2
Provimi final	1	3	3
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			125
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5.00
ECTS			5.00